



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 41/2011
Prishtinë, më 29.11.2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Berat Buzhala, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani, Biserka Kostiq dhe deputeti Latif Gashi.

Munguan: Sala Berisha – Shala dhe Visar Ymeri.

Pjesëmarrës të ftuar: **Ilir Mirena**, zëvendësministër për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor; Arben Çitaku, sekretari i përhershëm dhe Servet Spahiu, drejtor në Departamentin e Shpronësimit- MMPH.

Pjesëmarrës të tjerë: Haxhi Gashi- USAID/ Deloitte; Besnik Ramadanaj- KDI dhe Floriana Shala- OSBE.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina, Brikena Hoxha, konsulentë e Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Raportimi i ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në lidhje me nivelin e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme;

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Raportimi i ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në lidhje me nivelin e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme

Kryetari – Tha se në procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, ka qenë i ftuar z. Dardan Gashi, ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Mirëpo, ne jemi njoftuar më kohë që nuk mund të jetë i pranishëm në mbledhje për arsyeje të vizitës zyrtare jashtë vendit. Sot para nesh për të zëvendësuar ka ardhur Ilir Mirena, zëvendësministër për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, dhe ia kaloj fjalën për raportim në lidhje me nivelin e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Ilir Mirena (zëvendësministër për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor) - Tha se sa përket Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, siç e dini deri tani ky proces ka qenë pjesë e përbashkët e bashkëpunimit në mes disa ministrive siç janë: Ministria e Infrastrukturës; Ministria e Financave dhe Ministra për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor. Por tani Qeveria ka marrë një vendim në bazë të kompetencave që i ka më ligj, ku prej një janarit të vitit 2012 MMPH-ja të jetë organ shpronësues. Theksoi së për detajet si ka shkuar deri më tani procesi i shpronësimit, me mua sot është sekretari i përhershëm, z. Arben Çitaku dhe Servet Spahiu, drejtor në Departamentin e Shpronësimit, të cilët do të ju njoftojnë me gjerësisht në lidhje me nivelin e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Arben Çitaku (sekretari i përhershëm MMPH)- Tha se çështja e shpronësimit ka qenë një proces më i gjatë dhe me procedura më të gjata deri të marrja e vendimit për shpronësim. Më vendimin që e ka marrë Qeveria, që prej fillimit të vitit 2012, MMPH të jetë organ i vetëm shpronësues tanimë janë vënë konturat e qarta. Ne me kohë e kemi themeluar Departamentin e Shpronësimit që udhëhiqet prej një stafi profesional dhe kemi bërë një marrëveshje me Ministrinë e Financave, që ta bëjmë menaxhimin mjeteve buxhetore për shpenzimet dhe kompensimet e këtij departamenti. Pasi që organi shpronësues merr vendim për vlerën e shpronësimit atëherë Departamenti për Shpronësim merr vendimin për zotimin e mjeteve financiare. Ministra për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka përfunduar disa shpronësime dhe procesi është në drejtim të mirë. Lidhur më atë se si të bëhet mënyra e financimit dhe e ankesave të palëve që nuk pajtohen me vlerën e kompensuar, Gjykata Supreme ka kërkuar që të bëhet plotësim - ndryshimi i Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, për arsye se duhet të përcaktohet qartë kush duhet ta bëjë procesin e kompensimit dhe se duhet t'ju jepet mundësia palëve më ligj për ankesa duke filluar dhe nga gjykatat e rregullta.

Kryetari - Tha që grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme ka pasur takim dhe më përfaqësuesin nga Gjykata Supreme e Kosovës, dhe janë diskutuar këto çështje. Pyeti se si është vendosur deri të vlerësimi i pronës dhe cilat kanë qenë kriteret e vlerësimit nga ana e organit shpronësues? A ka data bazë të të dhënave MMPH-ja në lidhje me shpronësimin?

Hashim Dëshishku – Theksoi se janë ndarë vetëm 50 milionë në buxhetin e vitit 2012 për shpronësim dhe, pyeti se a mjaftojnë këto mjete? Pyeti se a ekziston ndonjë kompani që është e licencuar për vlerësimin e kompensimet së si duhet të caktohet vlera reale e pronës? Lidhur me ankesat që palët e pa kënaqura i drejtojnë gjykatave në afat prej 30 ditësh, pyeti se nëse nuk kthehet me kohë përgjigja çka ndodh më palët që kanë bërë ankesa?

Biserka Kostiq - Pyeti cili është bashkëpunim me komunat dhe çfarë do të ndodhë me pronat e uzurpuara të cilat janë në pjesën e ndërtimit të Autostradës Prishtinë- Shkup? Dhe sa ka të punësuar punëtorë nga komuniteti serbë në Departamentin e Shpronësimit në MMPH?

Ramiz Kelmendi – Pyeti për çështjen e çmimit së a ekziston një çmimore për vlerën pronës nëpër nivele, varësisht së ku ndodhet prona?

Arben Çitaku (sekretari i përhershëm MMPH) – U përgjigj në pyetjet e deputetëve se janë tri organe nëpër të cilat kalojnë çështja e shpronësimit, si Ministria e Infrastrukturës- është inicuese si subjekt kërkuar, Ministria e Mjedis dhe Planifikim Hapësinor është organi shpronësues, ndërsa organi vlerësues është Ministria e Financave. Për certifikimin e kompanive për vlerësim nuk e parasheh ligji në fjalë, por është një nënkomitet që i referohet çmimit të tregut, janë disa kategori të nivelit të vlerësimit. Për çështjen e rrugës Hani i Elezit kjo ka qenë dhe është kompetencë e Ministrisë së infrastrukturës, sepse kompensimi ka filluar para miratimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Servet Spahiu (drejtor në Departamentin e Shpronësimit MMPH) - Për mjete prej 50 milionë që janë ndarë nga Ministria e Financave janë bazuar në planifikimet e më hershme që janë bërë nga ministrinë e caktuara. Për çmimit nuk ka ndonjë çmimore të caktuar, sepse dallojnë prej vendit në vend dhe vendosës është çmimi i tregut. Të ankesat pas që vendimin përfundimtar e merr Qeveria, palët kanë të drejtën ankimit në gjykata dhe në Gjykatën Supreme, nëse këto nuk arrijnë që me aftin kohor të kthejnë përgjigje, përsëri lënda mbetet në fuqi dhe kompensimi mund të kryhet në mënyrë retroaktive. Bashkëpunimi me komunat është shumë i ngushtë dhe i ndërsjellë.

Arben Çitaku (sekretar i përhershëm MMPH) - Ne tani e kemi marrë një vendim ta krijojmë një arkiv në kuadër të MMPH-së dhe Ministria e Arsimit, KEK- u dhe Ujësjiellësi na kanë sjellë nga një kopje për arkiv se cilat prona janë shpronësuar gjër më tani.

Kryetari - Si kryesues grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, theksoj se tani jemi nga fundi i monitorimit të aktiviteteve dhe do kemi vizita nëpër disa komuna. Dhe në fund do ta organizojmë një dëgjim publik më të gjithë institucionet dhe palët e interesit që kanë bëjnë më zbatimin e Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Vazhdon mbikëqyrja e zbatimit të ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme sipas Planit të Veprimit të Grupit punues

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Zenun Pajaziti